



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.2.2021, ora 11.30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Vijimi i diskutimit nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.

Marrin pjese: Ermonela Felaj, Elona Gjebrea, Elena Xhina, Artemis Dralo, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Edmond Rrushi, Edmond Stojku, Nimet Musai, Arben Elezi, Ylli Shehu, Lefter Maliqi, Sadi Vorpsi, Spartak Braho, Adnor Shameti.

Mungojnë: Paulin Sterkaj, Alban Zeneli, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Myslim Murrizi.

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes.

Bilbil Bitri - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së.

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Artan Syziu – Përgjegjës në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi, kolegë!

Meqenëse kuorumi është i plotësuar, mund të fillojmë mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së mbledhjes do të kemi vijimin e diskutimit nën për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Pika e dytë e rendit të ditës është diskutimi në parim i projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.

Herën e kaluar lamë disa nene pa mbyllur në projektligjin, që sjell ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe votimin në tërësi.

Do të doja të rifillonim diskutimin ku e kemi lanë.

Kemi lënë të hapur diskutimin për nenin 6 të ligjit. Konkretisht, ne kemi diskutuar shkronjën “F”, e cila pati disa kontestime brenda Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Ndërkohë, nga mbledhja e kaluar deri më sot, nga Ministria e Mbrojtjes ka ardhur një propozim alternativ për përmbajtjen e kësaj shkronje. Unë po lexoj si propozohet të ndryshohet kjo shkronjë:

“...nga sulmet në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike, të një natyre seksuale, të kryera nga eprori ndaj vartësit ose ndaj ushtarakut në gradë më të ulët gjatë ose jashtë orarit të punës”. Pra, është hequr fjala “seksuale” në pjesën e parë, “ngacmimi” dhe shprehja “kur nuk përbën vepër penale”, me qëllim që subjekti të mund ta kallëzojë këtë gjë në prokurori. Vepra penale e ngacmimit seksual ndiqet me kallëzim jo me ankim, dhe, njëkohësisht, përbën edhe shkelje administrative për sa i përket raportit të Forcave të Armatosura, duke u konsideruar si një shkelje disiplinore shumë e rëndë dhe masat për këtë shkelje, natyrisht, janë shumë të rënda.

Do të doja të dëgjoja zotin Koçi dhe më pas relatorin.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Punë të mbarë të gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të Komisionit të Sigurisë Kombëtare!

Sigurisht, do të vazhdojmë diskutimin aty ku e lamë në mbledhjen e kaluar.

Për riformulimin e pikës së nenit, mendoj se një variant mund të ishte edhe ky kompromis, sikur të vendosim vetëm fjalët “edhe kur nuk përbën vepër penale”. Pra, edhe kur

përbën, edhe kur nuk përbën. Në të dyja rastet masa administrative ushtrohet, pavarësisht faktit që natyra e veprës përbën ose jo vepër penale. Pra, edhe kjo mund të jetë një kompromis.

Gjithsesi, është në tagrin tuaj. Mendoj se edhe formulimi i ofruar nga drejtori, zoti Shehu, është variant shumë i pranueshëm.

Ermonela Felaj – Po, zoti Qefalia?

Xhemal Qefalia – Jam dakord.

Nuk kam kontestim te ky nen.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ka ndërhyrje nga kolegët për propozimin e shkronjës “P” të nenit 6 të projektligjit?

Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me nenin 6 të projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7, që kishte të bënte me masat disiplinore, veçanërisht pika 3. Pati një diskutim mes relatorit dhe ministrisë, por nga këshilltarët e komisionit më bëhet me dije se Ministria e Mbrojtjes i qëndron propozimit të ardhur në parlament, që ky nen të konfigurohet me përmbajtjen e propozuar.

Mund ta kemi zotin Shehu në linjë?

Ismail Shehu - Faleminderit, zonja kryetare!

Ky është propozim. Drafti është qeveritar dhe ne e kemi shqyrtuar. Të gjitha këto masa janë hartuar nga një grup pune, ku ka pasur edhe ushtarakë, edhe civilë të Ministrisë dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Sërish, për të adresuar shqetësimin e zotit Qefalia, nuk bëhet fjalë për t'i hequr në mënyrë permanente gradën një ushtaraku, por është një masë administrative e përkohshme, e cila shkon jo më shumë se 1 vit. Pra, mund të jetë edhe 1 ditë, dhe maksimalisht 1 vit.

Në aspektin ligjor, në gjykimin tonë, nuk përbën asnjë problem, sepse është një praktikë që çdo ushtri e botës e ka. Pra, *dimotion* ndodhet kudo. Madje, edhe legjislacioni ynë e njeh si formë sanksionimi. Konkretisht, Kodi Penal Ushtarak, uljen në gradë, madje në formë permanente, e ka pothuajse në çdo dispozitiv sanksionues. Nëse ka masë me burg, gjobë e të tjera, shoqërohet edhe me ulje në gradë. Ne nuk e kemi çuar në këtë lloj ekstremi, pasi nuk bëhet fjalë për vepra penale, por për shkelje shumë të rënda disiplinore, e kemi dhënë si masë disiplinore dënuese, e cila shkon maksimalisht 1 vit. Pra, në fund të periudhës së dhënë, kjo masë hiqet dhe grada rikthehet. Pra, mund të jepet edhe 1 javë dhe në krye të javës mund ta rimarrësh gradën që kishe, ose mund të jetë maksimalisht 1 vit.

Në gjykimin tonë, në aspektin ligjor nuk diskutohet fare për problem, por edhe në aspektin e përshtatshmërisë, është më se e përshtatshme, sepse është një praktikë e konsoliduar dhe e aplikuar kudo në botë, nuk është risi jona.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehu!

Do t'ia kaloj fjalën relatorit dhe më pas do të flasë sërish zëvendëministri.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

E dëgjova zotërinë dhe, me gjithë respektin që kam për mënyrën se si e dha përgjigjen, nuk jam absolutisht dakord.

Mund të jetë vendim i marrë nga qeveria, sepse, normalisht, të gjitha projektligjet kalojnë nga qeveria dhe nuk është kiamet i madh. Për aq kohë sa kalojnë në një komision, patjetër që do të ketë edhe shoshitje në Komisionin e Sigurisë.

Unë do të doja që këtë përgjigje ta jepte një nga ushtarakët dhe jo një përfaqësues, sepse zotëria në fjalë, i cili flet se është konsultuar edhe me pjesëtarë të Forcave të Armatosura, do të bënte mirë të kishte parasysh edhe ata që kanë paradhoma në zyra rreth e përçark. Në konsultime me ushtarakët e vërtetë, ky është një veprim diskriminues, që i bëhet gradës së ushtarakëve. Nuk mundet një mjek, i cili ka marr gradën “mjek” ose “doktor” ta kthesh në infermier. Nuk mund, zotëri, një inxhinier elektrik nuk mund ta kthesh në elektrikist të thjeshtë, duke i hequr gradën. Meqenëse ky është një numër relativisht i vogël, siç thoni ju, që u jepen masa disiplinore, atëherë pse duhet ta vendosësh? Ajo është një gradë e fituar, një titull i fituar, prandaj nuk mund të talleni, të vini në diskutim gradën e fituar me eksperiencë, me përvojë dhe me komision, pra nuk mund t'ia hiqni gradën, një herë ta bëni gjeneral dhe një herë nëntoger. Kjo është e pafalshme. Unë e kundërshtoj këtë, do ta kundërshtoj edhe në parlament, madje do të llojoj edhe me kolegët e mi të opozitës, meqenëse ju nuk doni ta pranoni. Ky është një diskriminim që u bëhet forcave ushtarake, ku një oficer i ushtrisë shqiptare, i cili e ka marrë me meritë gradën, në të gjitha format, me të gjitha përpjekjet që ka bërë, për një masë disiplinore, sipas shkallës, unë e kuptoj fjalën “sipas shkallës”, atij t'i hiqet grada. Prandaj e kundërshtoj këtë dhe do të vazhdoj ta kundërshtoj edhe në seancë parlamentare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Koçi dhe pastaj dua të dëgjoj zotin Bitri.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, ftoj kolegët e komisionit që të mos futen në fushën e emocionalitetit, por të mbeten te racionaliteti dhe objektiviteti.

(Ndërhyrje e zotit Qefalia)

Emonela Felaj – Të lutem, zoti Qefalia, të dëgjojmë njëri-tjetrin.

Petro Koçi – Ne rrisim fashën e opsioneve për të dhënë një masë disiplinore përkundrejt një shkeljeje shumë të rëndë të disiplinës. Unë mendoj se rritja e opsioneve ruan dinjitetin e ushtarakut, që lidhet edhe me gradën. Por grada në vetvete nuk është dinjitet, grada vihet te spaleta, rëndësi ka dinjiteti i ushtarakut. Pra, duke rritur opsionet e dhënies së një mase disiplinore, ne ruajmë dinjitetin e ushtarakut, duke llogaritur proporcionalitetin e shkeljes shumë të rëndë të disiplinës.

Unë ju ftoj që ta kuptojmë këtë në parim, pra i gjithë synimi i projektit është pikërisht për ta ruajtur dinjitetin e ushtarakut. Njëherësh dua t'ju kujtoj një shprehje të Tesi D'erbervilleve, i cili thotë: “Nuk duhet të jesh patjetër mace për ta vizatuar atë”. Pra, të gjithë ne që jemi civilë në Ministrinë e Mbrojtjes, por edhe të tjerë, e kuptojmë mirë botën ushtarake, dinjitetin e ushtarakut dhe dinjitetin e karrierës së tij. Heqja e përkohshme e gradës ruan, në fund të fundit, dinjitetin e disiplinës së Forcave të Armatosura në raport me një sjellje të gabuar individuale të një ushtaraku. Kjo është më e rëndësishme se sa një individ.

Megjithatë, pa qenë egoist në këtë qëndrim, dua të them në parim edhe një herë dhe kjo është e fundit, që duke rritur opsionet, pra mundësinë për të përzgjedhur një masë, ruhet dinjiteti i ushtarakut, por ju e dini që ka masa edhe më të rënda se kaq.

Nëse ne do të linim një opion, pra ose të jepet, ose të mos jepet masa, atëherë do të linim vetëm opionin që të shkarkohet përfundimisht, t'i hiqen gradat dhe të lirohet nga ushtria. Por, jo, janë disa masa, që jepen në përputhje dhe në përpjesëtim të plotë me natyrën e shkeljes shumë të rëndë të disiplinës. Unë mendoj që këtë gjë duhet ta shikojmë shumë ftohtë, nuk është se na preket dinjiteti ne që po e prezantojmë projektin, por mendoj se meqenëse ky është një standard ndërkombëtar, pra është standard i NATO-s, është mirë që edhe në këtë çështje që mund të duket si e vogël të jemi natoistë dhe kur aprovojmë apo nuk aprovojmë diçka.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjalën e ka zoti Bitri.

Bilbil Bitri – Përshëndetje, zonja kryetare!

Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Kam përshtypjen se nuk do të gjej argumente më të plota se sa ato që folën dy kolegët, nga krahu tjetër i Forcave të Armatosura, zëvendësministri dhe drejtori juridik. Gjithashtu, nuk dua të cenoj mënyrën se si e ndjen dhe e percepton zoti Qefalia një gjë të tillë, r besoj se është në të drejtën e tij të shprehet për atë që mendon.

Nga pikëpamja profesionale, si ushtarak, asnjëri nga ne nuk e do masën disiplinore dhe luftën, pra ne jemi ata që i urrejmë këto gjëra, sepse masat janë për ne dhe lufta është për ne,

që luftojmë të parët. Por, në fund, që të funksionojmë si organizatë, ka një sistem masash dhe rregullash, të cilat aplikohen për ta mbajtur organizatën të fortë.

Nga pikëpamja e ngjashmërisë me të tjerët, që të mos e përjashtoj veten nga procesi i hartimit të këtij projektligji, ushtarakët e kanë parë dhe unë flas ushtarakisht, sepse ma kanë dhënë të drejtën e përfaqësimit, kjo është një masë që aplikohet në shumicën e ushtrive të NATO-s. Ajo që i krijon mbrojtje ushtarakut nga krahu tjetër është se kjo është një masë e përkohshme, pra nuk është e përhershme ,që ia heq të drejtën e ushtarakut për një gjë që ai e ka fituar njëherë me meritë, ashtu siç e tha edhe zoti Qefalia. Pra, edhe ushtritë e tjera të aleancës e njohin një gjë të tillë.

Çdo veprim unë do ta ndaja mes titullit dhe gradës, ku ka një ndryshim besoj. Asnjërit nga ne, pavarësisht çfarë grade ka, nuk i hiqet profesioni i ushtarakut, por secilit nga ne do t'i njihen meritat për gradën, në raport me sjelljen dhe përmbushjen e përgjegjësive që ka. Unë mbetem ushtarak, pra mbetem artiljer derisa të kem frymën gjallë, ndërsa gradën sa të jem i zoti në përputhje me detyrimet që kam, pra këtë do ta përcaktoj unë dhe vetëm unë. Prandaj, masën disiplinore e shikoj jo si diçka për të sulmuar ushtarakët, por si një mënyrë për të mbrojtur organizatën. Se në fund çdo organizatë krijon mekanizmat e saj, mekanizma të mbrojtjes për të krijuar mundësinë që të heqin nga radhët e tyre ose të t'u heqë mundësinë elementëve, që nuk janë të përshtatshëm ose nuk janë në pritshmëritë e organizatës që të mos e dëmtojnë të gjithë organizatën.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Bitri!

Atëherë, pasi kemi dëgjuar opinionet e zëvendësministrit të Mbrojtjes, të drejtorit Juridik të Ministrisë së Mbrojtjes, të drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, kolonel Bilbil Bitri, si dhe qëndrimin e kolegut tonë Qefalia, besoj se secili prej deputetëve ka reflektuar në lidhje me përmbajtjen që duhet të këtë ky nen.

Personalisht e mbështes variantin e propozuar nga Ministria e Mbrojtjes, pasi bën sens jo thjesht për argumentin që dhanë përfaqësuesit e saj, por sepse masa të tilla disiplinore edhe në raste të tjera janë të zbatueshme. Për shembull, prokurorët ulen në detyrë dhe ndëshkohen disiplinarisht, duke u shndërruar në oficerë të policisë gjyqësore. Kjo është një gjë e njohur, ndërkohë që në të drejtën civile për një prind të padenjë hiqet përgjegjësia prindërore. Po të shikojmë ligjin me hollësi, derisa ushtarakun e shkarkon dhe e liron nga Forcat e Armatosura, pra i hiqet grada përgjithmonë, kjo do të thotë se nuk është një gjë e fituar përjetësisht. Në momentin që kryen shkelje shumë të rënda, do të thotë se nuk je i denjë për të mbajtur atë gradë dhe përdorimi i masës disiplinore “Ulje në gradë” mua më duket një përshkallëzim për të

shkuar në masën ekstreme. Pra, më duket një lloj momenti për t'i dhënë mundësinë ushtarakut të korrigojë vetveten, më pas të vijojë misionin e tij brenda Forcave të Armatosura. Unë kështu e kam parë, por, gjithsesi, do t'ju ftoja ta votonim.

Xhemal Qefalia – Zonja kryetare, a mund të them diçka?

Ermonela Felaj – Po.

Xhemal Qefalia – Absolutisht argumentet që sollët ju ndoshta nuk janë të ngjashme me karrierën ushtarake. Gjithsesi, unë nuk dua të bëj debat me kolonelin, por një gjë duhet të kenë në konsideratë të paktën kolegët. Në momentin që zotëria ulet në gradë, natyrisht, ulet për shkelje dhe nuk ulet për punë të mirë, atëherë pse duhet ta bëjmë rikthimin në gradën e mëparshme, për meritë apo për çfarë? Kjo është një masë shumë e sqaruar “Ulje në gradë”, por unë habitem pse kolonel Bitri ka këtë mendim, sepse unë kam komunikuar personalisht me të, por ndoshta nuk e kam sqaruar në detaje. Në momentin që ulesh në gradë, atëherë që ta rimarrësh përsëri këtë gradë, duhet të japësh diçka tjetër, duhet të futesh sërish në komision dhe jo të kalosh afatin kohor të dhënies së masës së përkohshme. Ne e kemi parashikuar te masat disiplinore edhe uljen në detyrë, pasi ulja në detyrë ka të bëjë edhe me uljen e pagës së ushtarakut, ndërkohë ju e ulni në detyrë, e ulni në gradë dhe më pas ia rijepni sërish gradën. Ai person nuk mund të rikthehet më te grada e mëparshme, pasi nuk e ka autoritetin, nuk e ka më prestigjin që të kthehet sërish në gradën që ka mbajtur. Nëse është diskriminuese në momentin që ia heq gradën, për shembull nga “Kolonel” në “Nënkolonel” dhe më pas e rikthen sërish në gradën e mëparshme. Kjo është shumë e vështirë për dinjitetin dhe për prestigjin që ka ushtaraku. Gjithsesi, vendimmarrja është juaja dhe nuk dua të interferoj në vendimmarrje.

Ermonela Felaj – Ju kuptova drejt.

Atëherë, a mund të gjejmë një konsensus me ju, si relator, që në shkronjën “d” të këtij neni, në fjalinë e fundit, të vendosim kushtin që të mos rimerret grada automatikisht me kalimin e një viti, por të kushtëzohet me daljen para komisionit përkatës që e ka dhënë masën disiplinore, i cili verifikon kushtet e reja? A do të ishte një opsion ky, zoti Qefalia, më pas do të dëgjojmë edhe qëndrimin drejtorit?

Xhemal Qefalia – Kjo është një gjë pozitive që deri diku është më afër realitetit dhe unë këtë merak kisha, por vendoseni ju.

Ermonela Felaj – Në rregull, faleminderit!

Atëherë, e mira do të ishte të dëgjojmë edhe kolegët e tjerë që të merrni edhe opinionet e tyre për të na dhënë një përgjigje më të konsoliduar.

Zoti Duzha dhe më pas zonja Malo.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë ndaj të njëjtin qëndrim me relatorin. Nuk jam dakord me uljen në gradë, sepse, përderisa ai ulet në detyrë, mendoj se pjesa e gradës duhet të hiqet.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Malo.

Artemis Malo – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë kam një pyetje shumë të thjeshtë dhe të shkurtër për sa i përket ndëshkimit disiplinor. Nëse një ushtarak në gradë të lartë në rezervë do të marrë pjesë në fushatë, a ndëshkohet disiplinarisht, apo jo?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Malo, për pyetjen tuaj!

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit!

I dëgjova me vëmendje kolegët dhe, realisht, jam e paqartë për diçka, ndaj dua të bëj unë një pyetje për rastin konkret. Nëse hiqet grada për shkak të një shkeljeje disiplinore, si është menduar të rifitohet grada, se nuk e kuptova dhe nuk doli e qartë nga projektligji? Unë do të doja një përgjigje nga zoti Koçi ose nga zoti Shehu se si e kanë menduar ata rifitimën e gradës. A është kjo e parashikuar në ligj? A del qartë nga ligji, apo ka ndonjë akt tjetër nënligjor që kanë menduar ta nxjerrin në zbatim të këtij ligji? Pasi të dëgjoj përgjigjet, ndoshta do të bindem për votimin e saj.

Ermonela Felaj – A ka pyetje apo qëndrime të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, do të marrim një përgjigje nga zoti Koçi ose nga zoti Shehu, por patjetër edhe nga zoti Bitri, nëse dëshiron, në mënyrë që të ndihmojmë njeri-tjetrin në këtë diskutim.

Petro Koçi – Zonja kryetare, unë mendoj se nuk duhet ta komplikojmë më tej projektligjin lidhur me opsionin e dhënies së një mase disiplinore, pasi kjo ulje në gradë është e përkohshme. Në momentin që mbaron koha e masës disiplinore, automatikisht grada kthehet tek ushtaraku që e ka merituar kur ka kryer procesin e konkurrimit dhe më pas të gjykimit në komisionin përkatës. Të mos harrojmë që ne e kemi demokratizuar dhe e kemi decentralizuar dhënien e masave disiplinore. Pra, duhet parë në tërësi i gjithë projektligji, duke u përpjekur të ruajmë dinjitetin e disiplinës së organizatës, pra të Forcave të Armatosura, por edhe të ushtarakut në vetvete. Unë e ritheksoj, shtimi i opsioneve ose i fakteve që ka gjëra që rëndojnë apo e lehtësojnë dhënien e masës disiplinore. Pra, në momentin që autoriteti përkatës do të japë masën disiplinore, do të llogarisë të gjitha aspektet rënduese, ashtu edhe lehtësuese të *(nuk dëgjohet)*. E thashë, kjo nuk lidhet me egoizmin e qeverisë apo të Ministrisë së Mbrojtjes, ne po themi që të rritim opsionet. Më e rëndësishmja është aplikimi i një standardi, të cilin e ka

NATO dhe nuk cenon aspak dinjitetin e gradës së një ushtaraku dhe dinjitetin e atyre që kanë qenë në komisionin përkatës kur i kanë dhënë gradën ushtarakut. Heqja e përkohshme lidhet me një moment të caktuar, kur papritur një ushtarak ka kryer një shkelje shumë të rëndë të disiplinës, por është një shkelje që nuk meriton ta largosh përfundimisht nga Forcat e Armatosura, meriton uljen në gradë, në detyrë dhe në pagë. Kështu që, të mbetemi te ky gjykim. Pra, të ruajmë dinjitetin dhe disiplinën në Forcat e Armatosura dhe, natyrisht, të ndëshkojmë ato raste individësh, të cilët e cenojnë këtë dinjitet. Është shumë e thjeshtë dhe të mos e komplikojmë më tej. Unë them që kjo rrit mundësinë të respektohet meritokracia e ushtarakut. Edhe në rastet kur ai gabon, të kemi mundësinë që t'i japim një masë të përkohshme, në mënyrë që të rivijë te grada që ka pasur. Këtë e ka standard e gjithë bota. Kështu që kot hamendësojmë gjëra të tjera.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zonja Xhina, fjala për ju.

Elena Xhina- Faleminderit, zoti Koçi, për sqarimin!

Edhe unë jam shumë e bindur që ligji sjell standarde shumë të larta dhe ju falënderoj për ligjin që keni sjellë, por është detyra jonë që ligji t'i shohë me kujdes edhe ata që bëjnë gabime, ose marrin masa disiplinore, të jenë të mbrojtur nga ligji, sepse është standard i barabartë për të gjithë. Kështu që nuk mendojmë se bëjmë kompromise dhe as hollësira të tepërta duke parë me kujdes ato që mund të cenojnë interesat e të gjitha palëve që janë pjesë e ligjit.

Nëse shohim propozimin, ai nuk thotë: “Ulje e përkohshme në gradë”, por thotë: “Ulje në gradë” dhe fjalën “përkohësisht” unë e dëgjova nga ju, që thoni: “Ulet përkohësisht në gradë”. Unë jam shumë dakord që ulja në gradë duhet të jetë e përkohshme...

Petro Koçi- Deri në një vit. Pra, është e përkohshme.

Elena Xhina- Nuk është e shkruar aty, por është vetëm “Ulje në gradë”.

Ermonela Felaj- Zonja Xhina, është: “Jo më shumë se një vit”.

Elena Xhina- Ndoshta jam unë gabim, sepse përpara kam vetëm tabelën dhe jo të gjithë ligjin, por, nëse në ligj përcaktohet qartë standardi që ulja është e përkohshme deri në një vit, jemi shumë dakord, pasi masa mund të jetë më shumë se një vit, varet nga lloji i shkeljes që bën. Ka raste që mund të jetë më shumë.

Petro Koçi- Nuk mund të jetë më shumë se një vit, por deri në një vit.

Elena Xhina- E kuptoj, por për standardin tim, ka raste që ndoshta duhet të ishte më shumë se një vit. Jam shumë dakord me uljet në gradë si masa disiplinore vetëm duke pasur parasysh standarde...

Petro Koçi- Më shumë nuk e lejojmë ne, prandaj e kemi Xhemalin aty. Deri në një vit mund ta lëmë.

Xhemal Qefalia – Zoti Koçi, pse e ke vendosur një vit dhe jo 6 muaj, çfarë keni pasur parasysh?

Petro Koçi- Atë e ka vendosur i gjithë grupi i punës, nuk e kam vendosur unë. Unë jam këtu për ta mbrojtur në emër të qeverisë.

Xhemal Qefalia- Bëni mirë t’i dëgjoni edhe anëtarët e komisionit.

Petro Koçi- Mendoj se duhet ta shikojmë më ftohtë këtë situatë. Këtu nuk kemi avokatë ose kundëravokatë të dinjitetin të ushtarakut, mendoj se jemi të gjithë në një linjë, por është ë çështje e një perceptimi të caktuar, që na krijon këto ndjeshmëri, të cilat duhet t’i kapërcejmë.

Ermonela Felaj- Ju lutem, sepse dolëm pak nga diskutimi!

Neve na interesojnë argumentet më shumë se komentet.

Zoti Shehu, u bënë dy pyetje. Pyetja e parë ishte: në afatin maksimal që masa bie, a duhet një autoritet që ta konstatojë këtë gjë, apo do të mjaftoheni me kaq, siç e keni propozuar?

Pyetja e dytë e zonjës Malo. A ndëshkohet disiplinarisht ushtaraku i lartë në rezervë, i cili merr pjesë në fushatë elektorale?

Ismail Shehu- Faleminderit, zonja kryetare!

Lidhur me pyetjen e parë se kush i jep gradat, janë përcaktuar në dy ligjet e tjera, te ligji i pushteteve dhe ligji i gradave. Në qoftë se e gjykoni të nevojshme që të shkruhet që e rimerr gradën me urdhër të autoritetit kompetent, mund të shtohet, por që janë të përcaktuara nga legjislativi tjetër në fuqi. Pra, në momentin që është ulur grada nga komisioni, mbaron dënimi dhe e rimerr gradën, patjetër, me urdhër të autoritetit. Për gradën “oficer” e jep urdhrin ministri dhe për gradat “nënoficer” ose “ushtar” e jep urdhrin shtabi. Gjithsesi, në qoftë se e gjykoni që të shtohet një paragraf, ku mund të thuhet: “Me urdhër të autoritetit kompetent”, mund ta shtojmë dhe nuk ka problem, por kjo është çështje e trajtuar dhe e zgjidhur.

Lidhur me pyetjen e zonjës Malo, subjekt i këtij ligji janë ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura dhe ato në rezervë vetëm kur janë në shërbim ushtarak. Pra, për t’iu kthyer konkretisht pyetjes, në qoftë se një ish-ushtarak, një rezervist është rikthyer për një stërvitje, mision apo trajnim dhe mbështet fushatën politike, bën fushatë për një subjekt politik e të tjerë, patjetër që është subjekt i këtij ligji, por në qoftë se një ushtarak është në rezervë dhe nuk është rikthyer në shërbim për stërvitje, mision e të tjerë, nuk është subjekt i ligjit, sepse, de facto të qenit rezervist është shumë i ngjashëm edhe me të qenin në lirim. Pra, ke disa “benefite” si ish-ushtarak, por nuk je më aktiv, për pasojë nuk mund të ndëshkohesh disiplinarisht. Në qoftë se si rezervist unë të kam rikthyer për X apo Y arsye, ti në këtë rast patjetër që je subjekt i këtij

ligji dhe, në qoftë se ti kryen një shkelje të natyrës që ka të bëjë me fushatën politike, kë bërë një shkelje shumë të rëndë, për pasojë do të ndëshkohesh me një masë disiplinor për shkeljet shumë të rënda disiplinore sipas këtij ligji.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po bëj një propozim: a jeni dakord që ulja në gradë, pra germa “d” e nenit 7 të projektligjit të ketë këtë përmbajtje: “Ulja në gradë, e cila është një masë nëpërmjet së cilës ushtaraku ulet deri një gradë, por jo më shumë se 1 vit. Në fund të vitit ushtaraku rimerr gradën e mëparshme sipas ligjit përkatës.”? Në njëfarë mënyre, kjo sjell një lloj konsensus në atë që relatori tërhoqi vëmendjen, pra që të mos jetë automatike.

A kemi ndërhyrje tjetër?

Petro Koçi – Një rregullim. Jo “në fund të vitit”, por “në fund të periudhës së masës disiplinore”, sepse mund të mos jetë një vit.

Ermonela Felaj – Në fakt, “në fund të vitit” e kemi propozuar ju, prandaj e lexova ashtu.

Petro Koçi – “Në fund të periudhës që i është dhënë masa disiplinore”.

Ismail Shehu – Nëse mundem, zonja kryetare?

Ermonela Felaj – Po.

Ismail Shehu – Domethënë, “në fund të periudhës” është varianti më i saktë, pra ashtu siç e tha zëvendësministri. Do të ishte me e përshtatshme “me urdhër të autoritetit kompetentë sipas ligjit”, pasi ligji i pushteteve dhe i autoriteteve i ka përcaktuar. Autoriteti për dhënien e gradave është ministri, shefi i shtabit e kështu me radhë. Pra, thjesht një formulim në asketin teknik, por jemi dakord me propozimin tuaj.

Ermonela Felaj – Jam dakord edhe me ndërhyrjen e zotit Koçi, pra të mos themi “në fund të vitit”, por të themi “në përfundim të aftit të zbatimit të masës disiplinore, ushtaraku merr gradën me urdhër të autoritetit përkatës”. Në rregull, zoti Shehu?

Ismail Shehu – Po, shumë në rregull.

Ermonela Felaj – Pra, edhe një herë: “Në përfundim të aftit të zbatimit të masës disiplinore, ushtaraku rimerr gradën e mëparshme me urdhër të autoritetit përkatës”.

Ismail Shehu – Dakord.

Ermonela Felaj – Me këtë riformulim, dua t’ju ftoj për votim.

Kush është dakord me germën “d” me këtë riformulim? Kundër? 2 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me shumicë votash.

Kush është dakord me nenin 7 të projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Kishim lënë edhe dy nene të tjera. Neni 8 i projektligjit lidhet me rrethanat lehtësuese. Në fakt, nuk e lamë se patëm një diskutim të veçantë, por se përmbajtja e këtij neni është e kushtëzuar me nenin 7.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 9 është e njëjta gjë.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet neni 9.

Për nenet e tjera ne kemi pasur dakordësi. Dua një konfirmim nga ministria nëse gjatë rrugës kemi harruar diçka pa diskutuar. Besoj se jo.

Kam një mungesë të këshilltarëve sot për shkak të COVID-it, kështu që më duhet pak ndihma juaj.

Gjithsesi, besoj se kemi qenë korrektë me procedurën dhe me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Kështu që ju ftoj për votimin e fundit.

Kush është dakord me votimin në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi ky projekt.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, zoti Drejtor dhe zoti Kolonel!

Faleminderit edhe relatorit për durimin për të diskutuar deri në fund në lidhje me këtë projekt! Ditë të mbarë!

Sekretar
Antoneta Dhima

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Rashela Lalaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.2.2021, ora 10:40

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elona Gjebrea, Elena Xhina Duka, Artemis Dralo Malo, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Edmond Rrushi, Edmond Stojku, Nimet Musaj, Arben Elezi, Ylli Shehu, Lefter Maliqi, Sadi Vorpsi, Spartak Braho dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Alban Zeneli, Anduel Xhindi, Luan Harusha dhe Myslim Murrizi.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Artan Syziu – Përgjegjës në Drejtorinë e Kodifikimit.

Ermonela Felaj – Ashtu siç ju njoftova në fillim të mbledhjes, si pikë të dytë të rendit të ditës kemi prezantimin dhe diskutimin në parim të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”, pra për SHÇBA-në ose SHKB-në e burgjeve, siç është njohur ndryshe.

Të ftuar kemi zonjën Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë dhe zotin Artan Syziu, përgjegjës në Drejtorinë e Kodifikimit.

Zonjën Gjonaj dhe zotin Syziu i shikoj që kanë bërë akses në sistem.

Relatore për këtë projekt do të jetë zonja Xhina.

Ashtu siç e thashë, ne sot nuk do të kalojmë në diskutimin nen për nen.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Gjykoj, se duke qenë një projekt i ri, duhet t'i japim pak kohë vetes për të krijuar një ide sa më të qartë në lidhje me përmbajtjen e kësaj dispozite.

Meqenëse ministrja dhe zoti Syziu janë prezente, mund ta vijojmë mbledhjen.

Mirë se erdhët, zonja Ministre!

Faleminderit!

Fjala është për ju për të na prezantuar përmbajtjen e projektligjit që ju keni propozuar.

Faleminderit!

Etilda Gjonaj –Përshëndetje, e nderuar zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Së pari, uroj të jeni mirë me shëndet të gjithë ju dhe familjet tuaja!

Ju falënderoj për mundësinë, njëkohësisht, edhe për ecurinë e shpejtë që ka pasur përfshirja në kalendarin e draftligjeve për t'u diskutuar në komision dhe për t'u miratuar në seancën plenare. Ky është një ligj, për të cilin, në fakt, së bashku me 4 ligjet e miratuara në korrik të vitit të kaluar, për hir të së vërtetës, së bashku me të gjithë anëtarët e të dyja komisioneve u bë një punë e jashtëzakonshme, duke ndryshuar tërësisht kuadrin ligjor të sistemit penitenciar dhe të kuadrin ligjor për ekzekutimin e vendimeve penale. Njëkohësisht, ky është ligji i fundit i cili i bashkëngjitet kësaj pakete.

Propozimi i këtij projektligji erdhi si një nevojë e reformimit të Shërbimit të Brendshëm të Ankesave në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale për një shërbim më model, i cili të ketë mundësinë të ofrojë nëpërmjet organizimit të detyrave, të përgjegjësive, të strukturave dhe të personelit, duke marrë edhe atributet e Policisë Gjyqësore, ashtu si një sërë shërbimesh të kontrollit të brendshëm në institucionet penitenciare të vendeve europiane i kanë si attribute.

Me këtë ndërhyrje legjislative synohet përmbushja e objektivave afatgjatë të përcaktuara edhe në programin e qeverisë shqiptare 2017-2021, konkretisht në pikat e shtetit ligjor dhe drejtësia e re, ku parashikohet se pjesë e rëndësishme e këtij procesi reformimi do të jenë edhe institucionet penitenciare: burgjet, paraburgimi, si dhe Shërbimi i Provës, me qëllim rritjen në mënyrë efektive të veprimtarisë së këtyre institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale.

Ligji ekzistues është ai i vitit 2005 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij kanë disa boshllëqe të konsiderueshme ligjore në drejtim të përcaktimit qartë të parashikimeve ligjore lidhur me organizimin, kryerjen e detyrave, si dhe me veprimtarinë e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në

ekzekutimin e vendimeve penale, të cilat lënë shkak në mënyrë të vazhdueshme për keqinterpretim të ligjit dhe moszbatimin siç duhet të tij.

Gjithashtu, ligji në fuqi nuk ka të parashikuar misionin e shërbimit, statusin e punonjësit, karrierën në shërbim, si dhe formën apo mënyrën e emërimit, të transferimit dhe të shkarkimit, të cilat nuk janë të rregulluara në ligjin aktual, duke mos ofruar garancitë e nevojshme ligjore dhe të atyre që shërbejnë në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve.

Me këtë projektligj është përpjekur të adresohen disa nga problematikat e hasura në zbatim nga ligji aktual, duke mbajtur në konsideratë të gjitha parashikimet ligjore të reja të katër ligjeve, të cilat janë miratuar vitin e kaluar. Ato konsistojnë kryesisht në plotësimin e atyre boshllëqeve që lidhen me mungesën e efektivitetit të plotë të veprimtarisë së institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale në mbikëqyrjen e tyre; me trajtimin e kërkesë-ankesave sipas ligjit dhe respektimin e kuadrit ligjor nga ana e këtyre strukturave; me vakuumin ligjor që ekziston në fushën e rregullimit të Shërbimit, duke mos e përshtatur atë me kërkesat e kohës dhe me parimet mbi bazën e të cilave operojnë sot agjencitë e zbatimit të ligjit në fushën e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale, si dhe shkeljeve të ligjit të kryera nga punonjësit e strukturave, objekt pune gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj.

Gjithashtu, projektligji synon të plotësojë disa boshllëqe që lidhen me mungesën e investimeve reale dhe koherente në shërbim, duke mos pasur kështu një strukturë tërësisht të modernizuar apo edhe të mjaftueshme me burimet njerëzore dhe kapacitetet që do të duhet të kenë punonjësit në këtë shërbim, sipas roleve përkatëse; me mungesën e burimeve njerëzore dhe stafit të shërbimit, i cili të gëzojë të gjitha kapacitetet, arsimin dhe trajnimin e duhur për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligj, por duke mbajtur në konsideratë që janë një sërë ligjesh të tjera që janë miratuar edhe në kuadër të reformës në drejtësi, siç është ligji “Për Drejtësinë Penale për të Miturit”, kërkohej një harmonizim i ligjit që është në fuqi me parashikimet e reja ligjore. Gjithashtu, lidhet me mosefikasitetin në kontrollin e zbatimit të dispozitave të ligjit në fushën e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve nga tortura, dhuna, trajtimet çnjerëzore dhe johumane apo veprime të tjera që nxisin racizmin, probleme në përmbushjen e kërkesave ligjore në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale për Shërbimin e Provës, referuar kështu edhe vendeve të Bashkimit Europiane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe mospërcaktimin e qartë të fushave të veprimtarisë informative, gjurmuese dhe asaj hetimore, të cilat tashmë kanë një rregullim më të mirë në projektligjin, i cili është objekt diskutimi edhe në komision. Njëkohësisht, nëpërmjet

ndryshimeve të këtij projektligji kemi synuar edhe të rrisim besimin dhe reagimin pozitiv të publikut për funksionimin drejt të strukturave të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me ligjin.

Për herë të parë ne kemi parashikuar që Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve të jetë një strukturë e shkëputur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila do të ketë buxhetin e saj dhe do të jetë në varësi tërësisht nga Ministria e Drejtësisë, pra jo thjesht e vetëm funksionale, por edhe strukturore dhe buxhetore.

Ka pasur një moskuptim pse Drejtoria apo Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve buxhetin e kishte të parashikuar së bashku me atë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Duke pasur këtë varësi buxhetore, shpeshherë shërbimi nuk arrinte dot ta kryente funksionin e tij në kontrollin e veprimtarisë së punonjësve të sistemit të burgjeve.

Projektligji është hartuar nga një grup pune i propozuar nga ministri i Drejtësisë, ku kanë marrë pjesë jo vetëm përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, por edhe nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, por edhe ekspertë të përfshirë nga ambasada britanike.

Projektligji i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimesh në portalin e regjistrimit elektronik për njoftime dhe konsultime publike, për të cilin pas kalimit të afatit ligjor të publikimit nuk ka pasur komente në regjistër, por, nga ana tjetër, janë zhvilluar edhe një sërë tryezash diskutimi me përfaqësues të të gjitha institucioneve, me qëllim që të kishim të njëjtin proces, siç e kemi kryer për të katra projektligjet në sistemin e burgjeve.

Ndryshimet thelbësore që sjell ky ligj kanë të bëjnë me ristrukturimin, duke dalë si një strukturë, ashtu siç e thashë, e pavarur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe jo me këtë varësi të dyfishtë buxhetore dhe funksionale.

Ndryshimi i dytë lidhet me zgjerimin e fushës së veprimit të shërbimit nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit, por edhe të interesave të tatimpaguesve shqiptarë, duke forcuar kështu edhe më shumë luftën ndaj veprimtarisë së mundshme kriminale dhe të kundërligjshme nga çdo punonjës i cili është në strukturën e sistemit të burgjeve.

Fryma e riorganizimit të shërbimit synon përjashtimin e një impakti të madh tek të paraburgosurit, tek të dënuarit, por edhe te publiku për të rritur besimin që ankesat që ato do të paraqesin do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe me objektivitet.

Pa dyshim, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve në objektin e tij do të ketë jo vetëm trajtimin e ankesave të publikut, por edhe veprimtari të cilat lidhen me ruajtjen e integritetit të punonjësve; veprimtaritë kërkimore, me qëllim dhënien e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e aspekteve të organizimit dhe funksionimit të strukturave.

Njëkohësisht, në këtë projektligj përcaktohen edhe kriteret për përzgjedhjen e drejtorit të Shërbimit, duke vënë theksin tek integriteti, paanësia politike, pavarësia në drejtimin e strukturave që mbikëqyr dhe kontrollon, duke garantuar kështu edhe zbatimin e parimeve të pavarësisë dhe depolitizimit të Shërbimit.

Në projektligj janë parashikuar rregulla më të detajuara për punonjësit e Shërbimit, për kriteret e arsimit të tyre, trajnimin, si edhe procedurat e emërimit. Njëkohësisht, të njëjtat rregullime ligjore që janë parashikuar në paketën e ligjeve për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ne i kemi vendosur edhe për Shërbimin lidhur me transferimin apo përfundimin e marrëdhënieve të punës, të cilat kanë qenë në mungesë të parashikimeve ligjore në ligjin aktual.

Gjithashtu, kemi një ndarje të personelit në dy kategori, gjithmonë lidhur me objektin dhe qëllimin se si ky shërbim do të duhet të funksionojë, që ka të bëjë me pjesën operacionale dhe administrative. Personeli operacional do të jetë përgjegjës për ushtrimin e detyrave funksionale në fushën e veprimtarisë informative gjurmuese, analizën e informacionit kriminal dhe aplikimit të teknikave dhe metodave speciale të hetimit.

Ky projektligj ka ndikim edhe në pjesën sociale, por njëkohësisht edhe në rritjen e sigurisë së institucioneve penitenciare. Duke mbajtur në konsideratë që ka një objektiv shumë të rëndësishëm në luftën kundër kriminalitetit, por, gjithashtu, edhe kundër kriminalitetit brenda sistemit penitenciar, me parashikimet e reja ligjore në këtë ligj Shërbimit i jepet një frymëmarrje dhe rregulla strikte, me qëllim që të nxisim luftën kundër kriminalitetit edhe evidentimin e rasteve korruptive, që mund të jenë brenda sistemit penitenciar, lidhur me favorizime apo abuzime që mund të ketë për sa i përket favorizimeve që u bëhen personave të dënuar dhe të paraburgosur.

Miratimi i këtij ligji do të sjellë një rritje të standardeve lidhur me mbikëqyrjen dhe forcimin e luftës së parandalimit edhe për sa i përket sistemit 41-bis, i cili tashmë është një regjim i posaçëm, i vendosur në zbatim, ku struktura e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve do të japë me rolin e saj edhe një mbikëqyrje më të mirë të të gjitha veprimeve që kryhen nga personeli i institucioneve penitenciare.

Ky ishte një prezantim i shkurtër i projektligjit. Jam e hapur për çdo pyetje që mund të ketë nga anëtarët e komisionit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka relatorja, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

E falenderoj ministren për prezencën e saj në komision, por edhe për shpjegimin që i bëri projektligjit!

Është e vërtetë që ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, për sa kohë që shikojmë që Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave është tërësisht i transformuar dhe ka ndryshime thelbësore në këtë projektligj. Këto janë ndryshime të standardeve shumë të larta dhe kërkojnë të sjellin garanci dhe siguri më tepër në sistemin e burgjeve, duke ju bashkuar kështu, siç e shpjegoi edhe zonja ministre, paketës së sistemit penitenciar.

Është fakt që ky projektligj i ri e zgjeron shumë fushën e misionit të Shërbimit. Përveç të tjerave, ajo që për mua përbën risi dhe është shumë e rëndësishme është struktura operationale, e cila gati - gati ka kompetencat e organit të hetimit. Themi që kjo strukturë merr atributin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe realisht, po të shikojmë, gjatë projektligjit, vërtetë që ka këto lloj atributesh. Për mua këtu duhet të jetë edhe rëndësia e këtij projekti dhe kujdesit që duhet të tregojmë në gjatë shqyrtimit të tij nën për nen.

Për sa i përket këtij projektligji në parim, për mua është shumë i rëndësishëm dhe duket që është punuar me standarde të larta, pasi është përpjekur që të krijojë një kornizë të saktë ligjore, për të garantuar vërtetë një zbatim të drejtë të ligjit, sepse sa më shumë kompetenca ofron një ligj, aq më problematik është në zbatimin e tij, ndaj duhet të ketë shumë garanci brenda.

Unë nuk dua të ndalem më tepër në shpjegimin se çfarë ofron ky projektligj, sepse u shpjegua, por do të doja të dija nëse ky projektligj është nënshtruar për diskutim edhe me Prokurorinë e Përgjithshme, pasi, siç e thashë, fusha e kompetencave që i ofrohet Shërbimit ka të bëjë shumë me atë pjesë veprimtarie që, në fakt, janë attribute të prokurorisë. Nëse i është çuar për mendim Prokurorisë së Përgjithshme, cilat kanë qenë diskutimet që janë bërë lidhur me këtë projektligj, sepse për mua kjo pjesë është e rëndësishme?

Vërtetë që kjo strukturë e veçantë tashmë atashohet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe është bërë shumë mirë që është atashuar pranë saj, por kompetencat themelore të saj i përkasin hetimit. Ato janë risi dhe mjaft të rëndësishme, ndaj duhen parë me kujdes në mënyrë që të rregullohen dhe të jenë brenda kornizave të sakta ligjore.

Gjithashtu, duhet ushtruar kujdes gjatë shqyrtimit të ankesave dhe informacioneve të ardhura, nëse është parashikuar qartë korniza ligjore dhe hierarkia e shqyrtimit të ankesave, si dhe nëse është parashikuar qartë e drejta e ankimit. Këto do të jenë çështje që do t'i shikojmë me kujdes gjatë diskutimit nën për nen, pasi, siç e thatë edhe ju, zonja kryetare, kërkohet kohë që ne të njihemi qartë me risitë që ofron projektligji, nëse ai i është përmbajtur dhe nuk afektohet nga ligje të tjera, siç është Kodi i Procedurës Penale apo ligjet e sistemit penitenciar.

Për sa i përket diskutimit në parim, ky ligj vjen në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe Kushtetutën, ndaj neve nuk na pengon asgjë për ta miratuar.

Pyetja ime e vetme është nëse i është nënshtruar diskutimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, nëse ka mendime të ardhura prej saj, do të ishte mirë të na viheshin në dispozicion si komision.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhina!

Pas relativitetit të zonjës Xhina, e deklaroj diskutimin të hapur për kolegët. Nëse kolegët kanë pyetje për përmbajtjen e projektit, të pranishëm për t'u përgjigjur janë ministria, zoti Syziu, që e shoqëron ministren, por edhe relatorja që e njuh pak më në brendësi projektin, të gatshëm për t'i dhënë këto përgjigje.

Kush nga kolegët ka pyetje?

Për t'u dhënë pak kohë të gjithëve që të bëjnë pyetjet e tyre, a mund të bëjnë pyetjet e tyre, a mundet të kemi një përgjigje për pyetjen e zonjës Xhina? Pra, a është diskutuar projekti me përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, për të parë qëndrimin e tyre?

Etilda Gjonaj - Faleminderit!

Falënderoj dhe relatoren e projektligjit!

Në fakt, ky projektligj ka marrë një kohë shumë të gjatë dhe ka nisur si pjesë e paketës së katër ligjeve, që u miratuan në gusht, pra ka qenë pjesë e tyre, por duke mbajtur në konsideratë që u bënë disa ndryshime thelbësore, ky projektligj mori më shumë kohë edhe në proceset e diskutimit, edhe në proceset e konsultimit, por edhe në punën që vetë Ministria e Drejtësisë me grupin e ekspertëve ka kryer. Janë marrë pa dyshim jo vetëm si kërkesë ligjore, por edhe në tryeza është bërë diskutimi me Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe me një sërë aktorësh. Kjo ka ndodhur edhe në vitin 2019, edhe në vitin 2020, sepse, siç e thashë, puna për këtë paketë ka filluar shumë herët. Ndërkohë, kemi marrë komente jo vetëm nga Prokuroria e Përgjithshme, por dhe nga institucionet e tjera, si dhe nga aktorët e shoqërisë civile, të cilët janë reflektuar. Në çdo rast, ne mund t'ju vëmë në dispozicion tabelën e komenteve dhe çfarë është reflektuar për të gjithë aktorët, me qëllim që edhe për komisionin të jetë më e lehtë, kur të jetë pjesa e marrjes së mendimeve apo pjesa e konsultimit publik.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zonja Ministre!

Zonja Dhima dhe pastaj zonja Gjebrea.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin e projektligjit!

Unë kam vetëm një pyetje. Në fakt, në relacionin që shoqëron projektligjin, theksohet se drejtorja e shërbimit të kontrollit të brendshëm dhe ankesave në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale është e organizuar në katër sektorë, me një numër të përgjithshëm punonjësish prej 23 veta. Njëkohësisht, në të gjitha IEDP-të ka 36 punonjës, të cilët janë të përfshirë në këto struktura. Gjithashtu, në përlogaritjen që ju keni bërë, keni një kosto prej 18,8 milionë lekë. Pyetje ime është: A e keni parashikuar në buxhetin tuaj apo po kërkonti buxhet shtesë, për këtë numër shtesë prej 14 punonjësish, të cilët ju i keni parashikuar në këtë projektligj? Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zonja Dhima!

Po, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Ne i kemi parashikuar në zërat buxhetorë. Meqenëse kjo, ashtu siç thashë, ka qenë pjesë e paketës, ne ndërkohe jemi në miratimin e strukturës së re të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me gjithë institucionet penitenciare, por njëkohësisht edhe Shërbimin e Brendshëm të Kontrollit të Burgjeve, të cilat janë jo vetëm të parashikuara, siç ky ligj ka parashikuar strukturën, por njëkohësisht edhe në zërat buxhetorë të PBA-së, dhe të buxhetit të vitit 2021. Pra, nuk kërkohet asnjë fond shtesë për sa i përket strukturës së riformuluar të shërbimit të kontrollit të brendshëm të burgjeve.

Ermonela Felaj- Faleminderit, për përgjigjen!

Zonja Gjebrea dhe pastaj zonja Malo.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare! Të nderuar kolegë, e nderuar zonja Ministre,

Duke ju falënderuar për prezantimin e projektligjit, “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe të ankesave në sistemin të ekzekutimit të vendimeve penale”, e kuptoj rëndësinë, dhe shumë mirë që ka adresim për problematikat të cilat ju i keni hasur gjatë punës apo kontrollit të mëparshëm, si dhe duket që e zgjeron fushën e misioni të shërbimit nëpërmjet shumë hapave që ju merrni. Megjithatë, dua të jem pak e sinqertë në këtë që do të them, më krijohet përshtypja sikur ka një zgjerim të shërbimit, po aq sa mund të jenë shërbimet paralele në ministritë e tjera si Ministria e Brendshmen apo SHISH-i dhe të tjera. Si e mendoni, a është i drejtë ky perceptim imi? Nëse po, pavarësisht përgjigjes “po” ose “jo”, si e mendoni ju bashkëpunimin me shërbimet e tjera të ngjashme në ministri, që luajnë një rol të rëndësishëm për adresimin e problematikave, sipas kuadrit ligjor që kanë këto shërbime? Faleminderit dhe suksese!

Ermonela Felaj- Faleminderit, Zonja Gjebrea!

Në fakt, besoj se kjo përshtypje është e vërtetë, që vjen edhe si konsideratë e parë, duke parë vetë projektin e ri. Projekti i ri ka 64 nene, ndërkohë që projekti i vitit 2005 ka vetëm 25 nene, pra duket shumë ambicioze ideja për ta ringritur, për ta rithemeluar, për ta shkëputur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Burgjeve, për ta nxjerrë veçmas. Duke e parë në këtë logjikë, duket është shumë e ngjashme me organizimin që ka sot SHÇBA –ja apo Agjencia e Inteligjencës dhe e Mbrojtjes. Besoj se pyetja e zonjës Gjebrea, por edhe interesi i kolegëve, është pikërisht ky, domethënë, përse tani kjo ambicie për ta ngritur në këtë nivel Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Burgje? Natyrisht, edhe pyetja që bërë zonja Gjebrea, a presupozohet që ky shërbim të bashkëpunojë me homologët? A ka shërbime të ngjashme që funksionojnë në vende të tjera të BE-së?

Etilda Gjonaj – Faleminderit!

Pa dyshim që Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve ka një ngjashmëri në projektligj, në dispozitat ligjore me SHÇBA-në apo edhe me agjencitë informuese, siç mund të jetë rasti i SHISH-it, por ka një specifikë, sepse juridiksioni i SHKBB-së është vetëm në sistemin penitenciar, ku SHÇBA-ja apo Shërbimi Informativ, nuk kanë asnjë lloj kompetence dhe asnjë lloj juridiksioni brenda institucionit penitenciar, për sa u përket punonjësve të policisë së burgjeve, për shkak të aferave korruptive që mund të kryejnë në sistemin e burgjeve apo për shkak të abuzimeve ligjore që kryhen në sistemin e burgjeve.

Kjo iniciativë nuk është se vjen tani, ashtu siç e thashë, është shumë e hershme dhe ka qenë në gjenezë bashkë me paketën, por u shkëput për t’u ridiskutuar dhe meqenëse përfshihen disa kritere ligjore që lidhen edhe me emërimin, edhe me shkarkimin, me qëllim që këto kritere të mos bëhen abuzive në mënyrën e karrierës që punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, duhet të kenë brenda sistemit dhe **nëse marrim pjesën** edhe të funksionalitet në aspektin funksional apo të varësisë funksionale kjo strukturë është kështu siç është edhe në këtë projektligj, por në aspektin buxhetor dhe të mekanizmave financiare që do të duhet të jenë po njësoj si në aspektin funksional, ka ndryshimin që të jetë si një strukturë e pavarur në aspektin buxhetor.

Funksional është kështu siç është sot në projektligj, nuk është se ka ndonjë ndryshim, por për t’i dhënë një mekanizëm më shumë, që atë institucion që Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve e kontrollon, të mos ketë varësinë edhe financiare, por varësinë financiare ta ketë nga Ministria e Drejtësisë ashtu siç e kryen edhe tërësisht veprimtarinë funksionale.

Ndërsa për sa i përket bashkëpunimit me shërbimet, me prokurorinë, me SHISH-in apo edhe me organet e policisë, sepse në rastin konkret nuk kemi lidhje me SHÇBA-në, pavarësisht

se e kemi marrë si model për të përfshirë të gjitha garancitë ligjore që u jepen edhe punonjësve, do të ketë një bashkëpunim ashtu siç ka pasur deri tani. Ky bashkëpunim më shumë ka ardhur nga praktika dhe u është referuar edhe detyrimeve dhe përgjegjësive ligjore që punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, të cilët, kur kryejnë veprime hetimore, marrin urdhra nga prokurorët për veprimtaritë që kryhen brenda institucionit penitenciar dhe i marrin referimet nga ligjet specifike. Sot ka vetëm një specifikim më të mirë në projektligjin për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve.

Pra, ky bashkëpunim nuk diskutohet që do të vazhdojë, veçse janë parashikuar më mirë dhe në mënyrë më të qartë në ligj, që të mos ngelet pjesë të praktikës së një drejtuesi apo të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, por nuk ka asnjë konflikt në kompetencat dhe në juridiksionin që ushtron SHÇBA-ja, e cila nuk ka asnjë zë në kapitull sa i përket territorit ku është juridiksioni i sistemit penitenciar, si dhe nuk ka asnjë veprimtari që mund të kryejë Policia e Shtetit, përveçse bashkëpunimit dhe informimit. Ashtu siç edhe SHISH-i sot na sjell informacione të ndryshme për t'i verifikuar, kur ka informacione dhe indicie, të njëjtën veprimtari kryen edhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, por thjesht janë saktësuar në këtë projektligj në mënyrë që të mos lihet vend për abuzime.

Ermonela Felaj – Zonja Xhina, fjala për ju.

Elena Xhina – Faleminderit!

Duke marrë shkas edhe nga shpjegimi që na dha zonja ministre, doja të dija, sepse deri tani ky lloj shërbimi ishte atashuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, a ka pasur problematika në funksionimin e tij që kanë lindur si nevojë dhe që do të sjellin këtë ndryshim rrënjësor që të atashohet pranë Ministrisë së Drejtësisë?

Ne tashmë e kemi këtë strukturë me këto kompetenca, të cilat vërtetë janë të strukturuar dhe të zgjeruara dhe që marrin atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, por që kalojnë në varësi të ministrit. Do të doja të dija se cilat kanë qenë problematikat që janë konstatuar në funksionimin e kësaj strukture dhe se çfarë mendohet që do të sjellë si përmirësim ky ndryshim dhe atashim pranë Ministrisë së Drejtësisë? Faleminderit!

Elilda Gjonaj – Faleminderit, zonja Xhina!

Në fakt, po ta shihni pjesën e strukturës, ashtu siç e përmendi edhe zonja Dhima, 25 punonjës në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve janë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme, të cilët janë të lokalizuar në Tiranë, kanë disa veprimtari hetimore, operacionale në varësi të funksionit që kanë, si dhe 36 punonjës janë të përfshirë në strukturat e institucionit ekzekutiv të vendimeve penale. Kjo do të thotë që 1, 2 apo 3 inspektor të SHKKB-së në varësi

të numrit të dënuarve apo të paraburgosurve që ka një institucion janë të vendosur pranë këtij institucioni.

Pra, duke qenë pranë këtij institucioni, shpeshherë punonjësit e SHKKB-së janë ndier nën presionin e drejtorit të institucionit, i cili nuk ka varësi funksionale, përkundrazi inspektori kontrollon veprimtarinë e punonjësve të atij institucioni, ashtu si edhe veprimtarinë e drejtuesit për sa i përket pjesës së ligjshmërisë, të korrupsionit, të zbatimit të ligjit e me radhë. Shpeshherë është konceptuar sikur ata e kanë varësinë, meqenëse kanë varësinë buxhetore, duke qenë nën presionin e drejtuesit të institucionit. Për sa kohë që varësia e tyre institucionale është drejtpërdrejtë nga ministri i Drejtësisë, atëherë të gjitha detyrat dhe kërkesat i marrin nga drejtori i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, përveçse atyre detyrave procedurale që i marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga prokurori i çështjes në rastet kur ka filluar hetimi, pjesa tjetër nuk mundet të qëndronte nën presionin e drejtuesit të institucionit për sa i përket verifikimit apo rasteve të hetimit që kryejnë vetë inspektorët në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Pra, në tërësinë e tij nuk është se ka ndonjë ndryshim të madh, por ka të bëjë thjesht me faktin që ata nuk do të duan të jenë nën presionin e drejtuesit të institucionit apo edhe të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, pasi ashtu siç jua thashë varësia funksionale është tërësisht nga ministri i Drejtësisë dhe jo nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Por, duke pasur buxhetin, sepse siç edhe ju e dini, kur ke ndjeshmërinë që varesh për rrogën, për shpenzimet dhe për investimet, ke edhe një intimidim më të madh për ta kryer punën ashtu siç duhet sa u përket parashikimeve ligjore.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre, për përgjigjen tuaj!

Zonja Dralo, ka një pyetje.

Artemis Dralo – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Në fillim dua t'ju përgëzoj për punën serioze dhe shumë të detajuar, si dhe për përkushtimin që keni treguar gjatë gjithë kësaj kohe!

Pyetja ime ka të bëjë me SHKB-në. A mund të kem një bilanc pune për vitin që sapo mbyllëm të SHKB-së së burgjeve? Çfarë ka bërë ky shërbim dhe si ka qenë performanca e tij në vija të përgjithshme? Faleminderit!

Ermonela Felaj – Besoj se pyetja është me interes për të gjithë kolegët, për arsyen e thjeshtë që, nëse ne kemi kontakte me Shërbimin për Çështjen e Brendshme dhe ankesa dhe ka një raportim vjetor në Komisionin e Sigurisë, e njëjta është gjithë është edhe me Agjencinë e Inteligjencës dhe të Mbrojtjes, me Shërbimin Informativ Shtetëror, si dhe me Shërbimin e

Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve me të cilin jemi shumë pak të njohur. Ata nuk kanë qenë ndonjëherë të pranishëm në ndonjë komision parlamentar, sepse ligji nuk i detyron, për të raportuar për punën e tyre, kështu që besoj se një përshkrim i të dhënave të punës së tyre, aq më tepër tani, kur prirja është që ky shërbim të fuqizohet, në njëfarë mënyre të bëhet më i dukshëm, po ashtu dhe veprimtaria e tij, gjë që besoj se do të na ndihmonte. Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Në këtë moment, mua më duhet të marr të gjitha shifrat, zonja kryetare, e ndërkohë që mbase shifrat mund të më vijnë, ajo çfarë mund t'ju them është se vetë SHKBB-ja ka pasur një rritje të gjithë veprimtarisë së saj gjatë vitit 2020, krahasimisht edhe me vitet e kaluara. Kjo jo vetëm në çështje të cilat kanë kërkuar marrjen e masave disiplinore, po njëkohësisht edhe për çështje që janë referuar në prokurori. Ka pasur një numër të shtuar jo vetëm të atyre që janë persona të paraburgosur apo të dënuar, që kanë kryer veprime të paligjshme, vepra penale brenda institucionit, por njëkohësisht edhe për sa i përket veprave që lidhen me punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Më lejoni vetëm të marr shifrat dhe në një tabelë përmbledhëse, që ne kemi për vitin 2020. Për vitin 2020, SHKBB-ja ka referuar gjithsej 175 vepra penale në institucionin e prokurorisë, ndërkohë që deri tani janë marrë 11 masa, padyshim për sa u përket masave të vlerësimit nga ana e institucionit të prokurorisë, dhe nga këta 93 janë persona të dënuar e të paraburgosur. Njëkohësisht, është edhe një numër i caktuar familjarësh, sidomos kur bëhet fjalë për veprat penale të futjes së sendeve të paligjshme në institucionet penitenciare.

Finalisht, rezulton që për vitin 2020 janë proceduar penalisht gjithsej 53 shtetas. Duke pasur në konsideratë edhe faktin se ka qenë periudhë pandemie, padyshim që është ulur pak edhe numri i rasteve të referuara në prokurori, kjo edhe për shkak të disa masave që ne kemi ndërmarrë në institucionet penitenciare, të shkaktuara nga pandemia, kur takimet e familjarëve me të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë qenë të ndaluara. Shpeshherë, kjo ka bërë që edhe numri i konsumimit të veprave penale të këtij lloji të ketë qenë në numër më të ulët, për sa kohë që kanë qenë zero.

Ndërkohë, mund t'ju jap një shifër për sa i përket periudhës së shtator 2017-31 dhjetor 2020, kur numri i autorëve të proceduar me kërkesë të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, është për 966 shtetas. Autorë janë 24 drejtues të IEVP-së, apo të nivelit të lartë drejtues, 211 janë punonjës policie, 77 janë punonjës të administratës së sistemit të burgjeve, civilë, 568 janë të dënuar, të paraburgosur, dhe 86 janë familjarë. Nga të gjithë këta, së bashku me organin e prokurorisë, i cili ka kryer veprimet proceduriale, janë arrestuar apo ndaluar 157 shtetas, ndërsa 809 autorë ndiqen në gjendje të lirë.

Pra, po të marrim këto shifra, për këtë periudhë prej pothuajse tre vjetësh, rezulton që është një numër shumë i lartë i veprimeve që kryen Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve.

Ju përmenda vetëm shifrat e atyre, në lidhje me të cilët ka pasur indicie për vepra penale, pa referuar këtu rastet kur janë marrë procedime disiplinore ndaj punonjësve të Policisë së Burgjeve apo stafit administrativ.

Ermonela Felaj – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zoti Duzha.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Ministre, kam një pyetje për ju!

Ju keni pothuajse katër vjet si ministre. Pse mendoni që ky shërbim do t’i duhej më shumë Ministrisë së Drejtësisë, se sa Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, koleg!

Zonja Ministre!

Etilda Gjonaj – Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve ka qenë që herët, jo vetëm sot, siç thashë, me ndryshimet që i bëhen këtij projektligji, pra ka qenë një mekanizëm kontrolli i Ministrisë së Drejtësisë për sistemin e burgjeve. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka mekanizmat e tij, si të auditit, të sektorit të verifikimit, sektorëve të tjerë, që kryejnë hetimin apo procese të tjera inspektuese, për sa i përket veprimtarisë së punonjësve të Policisë së Burgjeve. Për këtë arsye, ky është një mekanizëm se si Ministri i Drejtësisë do të duhet të kontrollojë sistemin e burgjeve, për sa i përket ligjshmërisë së veprimtarisë që kryhet në këtë institucion. Nuk është se po ndryshohet sot. Ky është një sistem, një shërbim, i cili ka qenë funksional që herët, dhe ka qenë një mekanizëm i Ministrisë së Drejtësisë, kjo jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shumë vende të tjera europiane.

Ashtu siç thashë, ne kemi pasur një asistim nga ekspertët britanikë, mbi bazën e një projekti së bashku me Këshillin e Europës, të cilët kanë asistuar e kanë dhënë gjithashtu edhe referimet, rekomandimet, në lidhje me mënyrën se si duhet të jetë ky shërbim, me qëllim që të bëhet më efikas.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Pyetje të tjera nga kolegët?

Zoti Musaj, shoh që po na shikoni. Keni pyetje apo jo?

Mirë. Atëherë, në qoftë se nuk ka pyetje të tjera nga kolegët, gjithmonë duke iu përmbajtur asaj që thamë që në fillim të diskutimit të këtij projekti, se do të na duhet pak kohë

për ta realizuar në kuptimin e çdo dispozite të propozuar në projekt, unë do t'ju ftoja që në këto momente të bëjmë vetëm votimin në parim të projektit, për të vazhduar diskutimin e mëtejshëm të tij në një mbledhje tjetër.

Atëherë, kolegë, ju ftoj të bëjmë votimin në parim të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.

Kush është dakord me projektligjin?

Po. Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji!

Këtu mbyllet edhe diskutimi për ditën e sotme.

Ju faleminderit për prezencën, zonja Ministre!

Faleminderit zoti Syziu!

Faleminderit relatores, zonjës Xhina!

Faleminderit kolegëve të Komisionit të Sigurisë!

Mbetemi në kontakt në lidhje me mbledhjen e ardhshme.

MBYLLET MBLEDHJA